



*Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!*

**Në këtë buletin do të gjeni:**



*Takimi i 15-të teknik për Zbatimin e Dispozitave për Raportimin*



*Konferenca e Palëve, me temë "Të bëjmë të padukshmen të dukshme"*



*Integrimi i Partnerëve të Ballkanit Perëndimor në Punën e Agjencisë Europiane të Mjedisit*



*Dialogu i Parë i Komunitetit të Lëndëve të Para në Shqipëri*



*Takimi i Grupit Drejtues të HelpNet*



*Rritja e kapaciteteve mbi Protokollin e Montrealit dhe Amendamentit të Kigalit*



*Komuniteti i Energjisë për Klimën dhe Energjinë*



*Shkolla verore për kimikatet*



*Kuadri ligjor për burimet ujore*



*Projekti "Awesome Plus"*



*Fushata ndërgjegjësuese "Korrik pa plastikë"*



*Aktivitete të tjera të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*


## Takimi i 15-të teknik për Zbatimin e Dispozitave për Raportimin

Në datat 7-8 Maj në Agjencinë Europiane të Mjedisit në Kopenhagen u mbajt takimi i 15-të teknik për Zbatimin e Dispozitave për Raportimin.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga vendet anëtare të BE si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

Takimi u fokusua në:

1- Zbatimin teknik të direktivës rishikuar të Cilësisë së Ajrit të Ambientit (AAQD 2024/2881) e cila zëvendëson Direktivat 2008/50/KE dhe 2004/107/KE. Afati i fundit i transpozimit është 11 dhjetor 2026. Kjo direktivë, vendos kufizime të cilësisë së ajrit (p.sh., PM2.5: mesatarja vjetore  $10 \mu\text{g}/\text{m}^3$  deri në vitin 2030, Planet e cilësisë së ajrit (AQ) duhet të dorëzohen 2 muaj pas miratimit, Planet e veprimit afatshkurtër duhet të dorëzohen brenda 1 viti nga miratimi i tyre, në kuadër të raportimit vjetor dhe raportimi vjetor i pajtueshmërisë duhet të dorëzohet 9 muaj pas vitit kalendarik, d.m.th më 30 shtator të çdo viti)



2- Migrimin në ReportNet3, platformë e re për raportimin në EEA-s e cila bazohet në kalimin nga rrjedhat e të dhënave të fragmentuara XML (ReportNet2) në tabela të sheshta të integruara (ReportNet3), 17+ tabela që mbulojnë të gjitha fushat përkatëse (pajtueshmëri, matje, modelim, plane, masa, etj) në një rrjedhë të vetme të dhënash.

Afati kohor për miratimin e plotë me kontroll të vazhdueshëm të cilësisë (QC) dhe përditësime të vazhdueshme, do të jetë viti 2027.

Gjithashtu u rishikuan të dhënat me afat raportimi Dhjetor 2024 dhe raportimi për vitin 2025 si dhe demonstrimi në monitorimin e progresit të dorëzimit, importit, produktit si dhe mjetet e përditësuara të lidhura me Reportnet 3.



## Konferenca e Palëve "Të bëjmë të padukshmen të dukshme".

Nga data 28 Prill deri më 9 Maj 2025, dy specialistë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Sektori i Menaxhimit të Kimikateve, përfaqësuan si Pika Fokale e Konventave të Roterdamit dhe Stokholmit në Konferencën e Palëve në Konventat e Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit (BRS CoP) e cila u mbajt në Gjenevë, me temën: "Të bëjmë të padukshmen të dukshme"



Konferencat e Palëve u zotuan për një bashkëpunim më të fortë me marrëveshje dhe iniciativa të tjera mjedisore. BC COP-17 miratoi ndryshime në Shtojcën IV të Konventës udhëzime teknike të përditësuara mbi menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve të ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe një kornizë të re strategjike për zbatimin e Konventës për vitet 2025-2031. Konferenca gjithashtu inicioi një fushë të re pune që lidhet me adresimin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve tekstile.



Në kuadër të Konventës të Roterdamit (RC COP-12) u rënditën dy kimikate të reja në Shtojcën III të Konventës, pesticide Karbosulfan dhe formulimi i pesticidit shumë të rrezikshëm Fenthion (formulime me vëllim ultra të ulët në ose mbi 640 g përbërës aktiv/L).

Në kuadër të Konventës së Stokholmit u ndryshua Shtojca A e Konventës duke renditur tre kimikate të reja në të, përkatësisht pesticidin klorpirifos dhe dy grupe kimikatesh industriale, acidet perfluorokarboksilike me zinxhir të gjatë (LC-PFCA) dhe parafinat e klorinuara me zinxhir të mesëm (MCCP). Përveç kësaj, Palët miratuan programin inaugurues të punës së Komitetit të Pajtueshmërisë së Konventës dhe ia transmetuan nevojat e financimit për zbatimin e Konventës Fondit Global të Mjedisit.



## Integrimi i Partnerëve të Ballkanit Perëndimor në Punën e Agjencisë Europiane të Mjedisit

14 Maj 2025, Vienë. Takimi Përfundimtar i Integrimit të Partnerëve të Ballkanit Perëndimor në Punën e AEM-së – Përmirësimi i Tranzicioneve të Qëndrueshmërisë: Kontributet e Vendeve në RGJM 2025, mbledhi përfaqësues nga Agjencia Evropiane e Mjedisit Agjencia e Mjedisit e Austrisë dhe nga Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia.

Takimi kishte për qëllim:

- ✚ Përfundimin e aktiviteteve kontraktuale të projektit;
- ✚ Lehtësimin e shkëmbimit të përvojave, sfidave dhe mësimave midis vendeve pjesëmarrëse;
- ✚ Diskutimin e prioriteteve dhe mundësive të ardhshme për angazhim dhe harmonizim të vazhdueshëm me politikën dhe kornizat e raportimit mjedisor evropian.



Ai shërbeu si një ngjarje përmbyllëse për fazën aktuale të bashkëpunimit dhe ofroi një platformë për të reflektuar mbi punën e përbashkët të kryer në kuadër të projektit, veçanërisht në kontekstin e kontributeve në RGJM 2025 duke hartuar vlerësimet e ndryshimeve socio-ekonomike dhe duke thelluar bashkëpunimin midis Ballkanit Perëndimor dhe Agjencisë Europiane të Mjedisit.

Takimi përfundoi me një përmbledhje të pikave kryesore nga Fabian Kracmar nga Agjencia e Mjedisit të Austrisë. Ai falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe kontributet e tyre gjatë gjithë projektit dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së momentit të krijuar nga ky bashkëpunim.

Pjesëmarrësit ranë dakord se, ndërsa mbeten sfida të rëndësishme - veçanërisht në fushat e të dhënave dhe koordinimit institucional - përvoja ka hedhur një themel të fortë për një integrim më të thellë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në strukturat dhe sistemet e njohurive mjedisore të Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM).

### Dialogu i Parë i Komunitetit të Lëndëve të Para në Shqipëri

Qendra Rajonale e Inovacionit EIT RawMaterials, organizoi më 21-22 Maj 2025 Dialogun e Parë të Komunitetit të Lëndëve të Para në Shqipëri, : “Sfidat dhe Perspektivat e Sektorit të Minerave në Shqipëri dhe Rajon në Kontekstin e Ligjit për Lëndët e Para Kritike” të mbështetur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, EIT RawMaterials, Ambasada e Republikës së Polonisë në Tiranë dhe Projekti Hubs4Circularity.

Ky aktivitet dy-ditor mbledhi së bashku 120 palë të interesuara të larta dhe politikëbërës, ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues nga academia, sektori privat dhe partnerë zhvillimi në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për të eksploruar të ardhmen e lëndëve të para kritike në rajon. Përfaqësues nga qeveria, dhe aktorët kryesorë të industrisë shkëmbyen perspektiva mbi inovacionin, bashkëpunimin rajonal dhe rrugët drejt zhvillimit të qëndrueshëm.



Dita e parë e aktivitetit u përqendrua në potencialin e lëndëve të para kritike të Shqipërisë dhe sfidat dhe mundësitë e integritit në zinxhirin evropian të vlerave. Diskutimet nxorën në pah implikimet e Aktit të BE-së për Lëndët e Para Kritike (Akti CRM) për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor, duke i kushtuar vëmendje harmonizimit të politikave, perspektivave të investimeve dhe planifikimit strategjik. Një sesion i dedikuar pasdite trajtoi kalimin në një ekonomi rrethore, duke shfaqur strategji kombëtare, projekte ndërkombëtare dhe kërkime të aplikuara në simbiozën industriale dhe vlerësimin e mbetjeve.

Ky dialog vjen pas Samitit të fundit të Lëndëve të Para EIT në Bruksel, i cili nënvizon fokusin në rritje në lëndët e para kritike dhe mundësitë e reja për inovacion, zhvillim biznesi dhe bashkëpunim akademik. Ky aktivitet shfaqti rëndësinë strategjike të sektorit dhe mundësitë përpara drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe konkurruese".



Dita e dytë theksoi inovacionin dhe përparimin teknologjik në miniera. Me kontribute të forta nga kompanitë polake, aktiviteti prezantoi zgjidhje të përparura në eksplorim, përpunim dhe nxjerrje. Bizneset lokale dhe rajonale ndanë njohuri mbi aktivitetet dhe planet e tyre të ardhshme, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e transferimit të teknologjisë dhe praktikave të qëndrueshme

Ky Dialog shërbeu si një platformë e rëndësishme për nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërtimin e momentit drejt një sektori të lëndëve të para më të qëndrueshme, elastike dhe konkurruese, në përputhje me standardet evropiane.

## Takimi i Grupit Drejtues të HelpNet

Për herë të parë Shqipëria mori pjesë si vëzhguese në takimin e 20-të të Grupit Drejtues të HelpNet dhe rregulloreve (BPR, CLP dhe REACH) që u zhvillua nga 20 deri më 22 maj 2025, në Helsinki, ku morën pjesë 91 përfaqësues, përfshirë përfaqësues nga Komisioni Evropian, përfaqësues të institucioneve të vendeve europiane dhe atyre kandidatë për EU, vëzhgues të industrisë, kolegë të ECHA-s etj.



Nga Shqipëria pati një përfaqësim nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe dy përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte:

- Rritja e kuptimit të detyrimeve të Shqipërisë sipas Protokollit të Montrealit dhe Amendamentit të Kigalit.
- Ndërtimi i kapaciteteve të inspektorëve për të monitoruar dhe zbatuar kontrollet mbi substancat që shkatërrojnë ozonin (ODS) dhe hidrofluorokarbonet (HFC).
- Prezantimi i mjeteve praktike për inspektimet në terren, raportimin dhe koordinimin me doganat dhe organet e tjera përkatëse

Takimi filloi me prezantimin e pare, "Klima dhe Unë", në një mënyrë sa më të thjeshtë dhe të keptueshme. Me pas të gjithë pjesëmarrësit ndanë shkurtimisht se si çështjet klimatike dhe mjedisore ndikojnë në jetën e tyre të përditshme ku theksi u vendos mbi rolin e rëndësishëm të inspektorëve mjedisorë dhe zyrtarëve të tjerë të zbatimit të ligjit në mbrojtjen e klimës dhe shtresës së ozonit. Më pas u vijua me sesionet, ku u prezantuan:

- ✓ Përmbledhje e Protokollit të Montrealit - Historia dhe arritjet e Protokollit të Montrealit. Substancat kryesore të kontrolluara dhe afatet kohore.
- ✓ Amendamenti i Kigalit; Sfidat e Reja - Hyrje në Amendamentin e Kigalit. Detyrimet e Shqipërisë sipas Amendamentit dhe skema e uljes graduale të HFC-ve.
- ✓ "Korniza Ligjore dhe Rregullatore në Shqipëri - Legjislacioni aktual kombëtar mbi ODS dhe HFC. Licencimi, kuotat dhe kufizimet e importit/eksportit"
- ✓ "Roli i Inspektorëve Mjedisorë - Përgjegjësitë e inspektorëve në sigurimin e përputhshmërisë. Koordinimi me doganat dhe agjencitë e tjera"
- ✓ Procedurat Praktike të Inspektimit - Identifikimi i pajisjeve që përmbajnë ODS dhe HFC. Teknikat e inspektimit në vend. Trajtimi i importeve ose përdorimit të paligjshëm
- ✓ Studime rastesh dhe punë në grup - Rishikimi i rasteve reale ose të simuluar. Diskutim në grup mbi identifikimin e parregullsive dhe mospërputhshmërisë. Praktikat më të mira

## Rritja e kapaciteteve mbi Protokollin e Montrealit dhe Amendamentit të Kigalit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Njësine e Ozonit zhvilluan në datë 2 Qershor 2025, takimin me temë "Trajnim për trupat inspektuese të Mjedisit dhe Specialistët e Drejtorive Teknike", në kuadër të rritjes së kapaciteteve mbi Protokollin e Montrealit si dhe Amendamentit të Kigalit, specifikisht në detyrimet ligjore për implementimin e ligjit Nr. 2/2023 "Për Gazet Serrë të Floruara".

Fokusi kryesor ishte Forcimi i Përputhshmërisë ndërmjet Protokollit të Montrealit dhe Amendamentit të Kigalit nëpërmjet njohjes me gazet të cilat kanë Potencial shumë të lartë të ngrohjes globale (GWP) të cilat kanë filluar të largohen gradualisht nga përdorimi, kush nga këto janë të lejueshme në vendin tonë, monitorimi i tyre, ngritja e databazës si dhe detyrimet e raportimit në organizmat ndërkombëtare si dhe jo më pak e rëndësishme inspektimi i tyre.



## Komuniteti i Energjisë për Klimën dhe Energjinë

Takimi vjetor – “Raportimi i Komunitetit të Energjisë për Klimën dhe Energjinë sipas Rregullores së Përshtatur të Qeverisjes”, me pjesëmarrje fizike, i bashkëorganizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit, u mbajt me datë 3-4 Qershor në Varshavë, Poloni. Ai u prit nga Instituti Polak i Mbrojtjes së Mjedisit (IOŚ-PIB). Takimi mblodhi së bashku krerët e njëjësive të ndryshme klimatike dhe energjise dhe raportuesit kryesorë nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, së bashku me përfaqësues nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, DG ENER, DG CLIMA, DG ENEST dhe EEA.



Diskutimet u përqendruan në forcimin e përdorimit të të dhënave të klimës dhe energjisë për të informuar politikatat dhe vendimmarrjen, ndarjen e përvojave dhe sfidave që lidhen me raportimin sipas Rregullores së Qeverisjes së adaptuar dhe identifikimin e mënyrave për të përmirësuar proceset e raportimit. Pjesëmarrësit eksploruan planet e ardhshme dhe dhanë reagime për të udhëhequr përpjekjet e vazhdueshme të mbështetjes.



Pikat kryesore përfshinin prezantime nga Palët Kontraktuese mbi progresin kombëtar, diskutime të hapura mbi boshllëqet e pajtueshmërisë dhe nevojat e mbështetjes teknike, dhe një prezantim të projektit LIFE ENSPIRE të IOŚ-PIB dhe mekanizmave të tjerë të mbështetjes në dispozicion. Takimi përfundoi me reflektime nga EEA dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbi mësimet kryesore të nxjerra dhe hapat e mëtejshëm të propozuar.

## Shkolla verore për kimikatet

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ishin pjesë e kursit të shkollës verore që synonte vlerësimin e rrezikut kimik, duke përfshirë POP-të.



Kursi u mbajt në Universitetin RECETOX Masaryk në Republikën Çeke më 9-13 Qershor 2025 në dy module, 9-10 Qershor mbi vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut kimik dhe më 11-13 Qershor mbi Metodologjitë e Qasjes së Re (NAM) dhe vlerësimin e rrezikut të kimikateve.

## Kuadri ligjor për burimet ujore

Në datë 24 korrik 2025 u zhvillua takimi i gjashtë i GNP për hartimin e akteve nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit.

U diskutua Projekt VKM "Për përcaktimin e kufijve hidrografikë dhe territorialë të pellgjeve të lumenjve dhe rajoneve të pellgjeve të lumenjve dhe trupave të tjerë ujorë sipërfaqësorë, ujërave nëntokësore dhe bregdetare në rajonet individuale të pellgjeve të lumenjve, qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre, si dhe miratimin e elementëve të informacionit për secilin autoritet kompetent".

Qëllimi dhe rëndësia e aktit nënligjor në zbatim të Ligjit Nr. 29/2024 "Për burimet ujore" qëndron në garantimin e një kuadri të qartë dhe funksional për menaxhimin, mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përputhje me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.

Diskutimi mbi përmbajtjen e aktit nënligjor përfshin analizën e dispozitave që rregullojnë procedurat e administrimit të ujërave, të drejtave dhe detyrimeve të përdoruesve, mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë kuadër, anëtarët paraqesin propozime konkrete për përmirësimin e akteve ekzistuese ose për shtesa të reja, me synim që rregullimi nënligjor të jetë më gjithëpërfshirës, më i qartë në zbatim dhe më efektiv në praktikë.

## Projekti Awesome Plus

Përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit morën pjesë në Workshop-in me temë "*Life cycle assessment in new building materials and business models*", i cili u zhvillua më datë 29 korrik 2025, Hotel Doro, Tiranë.

Ky workshop ishte një aktivitet përmblyës i projektit në kuadër të Interreg, bashkëfinancuar nga BE, me titull "**Awesome Plus**", në të cilin janë përfshirë Shqipëria, Italia dhe Mali i Zi.

The RecycAl Eco-Education-Center



Qëllimi i workshopit ishte integrimi i konceptit të ekonomisë qarkulluese në zhvillimin e materialeve novatore të ndërtimit dhe në përpilimin e modeleve të reja të biznesit, si dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis të tyre, duke marrë në konsideratë ciklin e plotë të jetës, duke nisur nga prodhimi dhe duke vijuar me përdorimin dhe riciklimin.

Njëri nga prezantimet në këtë workshop ishte i z. Lulzim Baumann, që paraqiti gjetjet e projektit të tij **"Recycling Albania"**, i cili duke përdorur zgjidhje qarkulluese dhe mbetjet nga bujqësia, ka realizuar një ndërtesë të gjelbër (me mbetje zero dhe karbon-neutrale) në një qytezë të Shqipërisë



## KORRIK PA PLASTIKË

Përgjatë muajit korrik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka zhvilluar takime në një sërë subjektsh tregtare me synim sensibilizimin për mos përdorimin e qeseve plastike dhe produkteve plastike njëpërdorimshe.

Kjo iniciativë synoi ndërgjegjësimin e publikut për ndikimin negativ të mbetjeve plastike në mjedis si dhe nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme në përditshmëri, veçanërisht gjatë proceseve të blerjes. Fushata vijoi përgjatë muajit korrik për të inkurajuar njerëzit të reduktojnë përdorimin e plastikes njëpërdorimshe për një muaj të tërë dhe duke ofruar alternativa të tjera mjedisore të përdorimit të çantave që nxitin zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të ndihmuar në reduktimin e mbetjeve plastike njëpërdorimshme.



Qëllimi ishte për të ndërgjegjësuar shitësin dhe blerësin për ndikimin negativ të plastikës në mjedis. Të nxisë zëvendësimin e qeseve plastike me alternativa të qëndrueshme si; qeset prej pëlhure, apo letre. Të ulë ndotjen nga plastika në dete, lumenj dhe natyrë.

Gjatë kësaj fushate janë realizuar:

- Takime ndërgjegjësuere me 342 subjekte tregtare në Tiranë.
- Vendosja e materialeve informuese në ambientet e brendshme të marketeve.
- Komunikim i drejtpërdrejtë me stafin menaxherial, me arkën ose direkt me shitësin ambulant me qëllim informimin dhe nxitjen e përdorimit të çantave alternative dhe zëvendësimin me materiale të riciklueshme e të biodegradueshme. Reduktimi i produkteve plastike njëpërdorimshe që përdoren për shitje.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve/blerësve të rastit, gjatë realizimit të takimeve me bizneset.

Informimi i bizneseve se trashësia e qeseve plastike të lejuara është mbi 70 mikron. Qeset duhet të jenë të biodegradueshme ose të riciklueshme, dhe me përmbajtje të ulet plastike. Qeset duhet të shiten me pagesë dhe jo të shpërndahen falas nga dyqanet në mënyrë që blerësit të nxiten për të marrë çantat e tyre me vete.

## REDUKTO -RIPËRDOR-RICIKLO

*Merr dhe ti angazhimin tënd për të zvogëluar ndotjen nga plastika!*



Ne besojmë se përmes bashkëpunimit dhe informimit, mund të ndërtojmë një komunitet më të pastër dhe një të ardhme më të gjelbër

## Aktivite të tjera të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Gjatë periudhës Maj-Gusht 2025, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i ka kushtuar vëmendje aktiviteteve të mëposhtme:

### ◆ Në fushën e kimikateve

Helpdesku është përditësuar vazhdimisht. Baza ligjore ofron këshilla për prodhuesit, importuesit dhe çdo palë tjetër të interesuar mbi plotësimin e kërkesave sipas legjislacionit në fuqi.

Në Webfaqen e krijuar për Kimikatet gjatë kësaj periudhe, janë përditësuar informacione mbi mjedisin dhe kimikatet.

Në kuadër të REACH dhe CLP, Agjencia Europiane e Kimikateve ka zhvilluar trajnime të ndryshme ku përfaqësues nga Sektori i Menaxhimit të Kimikateve morën pjesë online, trajnimi u përqendrua në një përditësim të përgjithshëm të CLP, Rregullores Nr. 1272/2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin (CLP) të Substancave dhe Përzierjeve.

Për të promovuar përdorimin e sigurt të kimikateve dhe për të siguruar që informacioni përkatës dhe përditësimet më të fundit janë të disponueshme për publikun, ECHA krijoi një podcast mbi kimikatet ku ekspertët dhanë pikëpamjet e tyre mbi sigurinë kimike në BE. Temat kryesore përfshijnë mikroplastikat, klasat e reja të rrezikut të CLP, etj.

Pjesëmarrje në seminarin rajonal, me temë *"Chemical Weapons Convention and Chemical Safety and Security Management for Member States of the OPCW in the Eastern Europe Region"*, i mbajtur në 17-19 Qershor 2025 Hotel Rogner, Ky seminar u organizua nga Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW), në bashkëpunim me Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).



Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM-së) i emëruar si Pikë Fokale e Konventës së Roterdamit gjatë kësaj periudhe, Maj – Gusht 2025, ka marrë pjesë në disa takime online për Procedurën PIC dhe në kuadër të saj gjatë kësaj periudhe janë marrë 7 Njoftime Eksporti nga ECHA. Për të forcuar legjislacionin kombëtar të kimikateve në fuqi, për çdo njoftim të marrë, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në bashkëpunim me institucionet që merr pjesë në autorizimin e kimikateve në Shqipëri, ka kryer një proces verifikimi, ka përgatitur formatet për dhënien e përgjigjeve në lidhje me procedurat e PIC, bazuar në zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 21.9.2016, për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

#### ✦ *Në fushën e monitorimit të VNM dhe Lejeve Mjedisore*

Janë evidentuar subjektet të pajisur me Leje Mjedisore dhe VNM, të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimeve në zbatim të legjislacionit në fuqi:

Konkretisht u evidentuan:

1. Subjekte që nuk kanë raportuar në zbatim të detyrimeve të Lejes Mjedisore – 16 Leje Mjedisore Tipi A dhe 613 Leje Mjedisore Tipi B
2. Subjekte që nuk kanë raportuar në zbatim të detyrimeve të VNM - 922
3. Subjekte që kanë kërkuar pezullim të Lejes Mjedisore dhe kanë Leje të Vjetra - 183
4. Subjekte që kanë revokuar Lejen Mjedisore - 104



